

FJALA JONË



VENDIMI YNË

DEMOKRACIA, ATY KU FJALA JOTE KA VLERË

FLORENT (13), DION (13), DIELLZA (14), ARDIAN (14), ALBERTINA (14), REKLETA (13), HEKURAN (13)



Nga ne do të mësoni se pse është e rëndësishme të jetojmë në një shtet demokratik

Të jetosh në një shtet demokratik do të thotë të jetosh në liri dhe në paqe. Falë demokracisë, ne kemi lirinë e shprehjes dhe kemi të drejtat e barabarta. Demokracia për herë të parë është shfaqur në Athinë të Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Për dallim nga atëherë, sot kemi demokraci më të plotë sepse të gjithë e kemi të drejtën e votës mbi moshën 18 vjeçare, pra të gjithë marrim pjesë në vendimmarrje. Jemi shumë me fat që jetojmë në një shtet demokratik siç është Kosova, ku zbatohen të gjitha parimet e demokracisë, të cilat janë: liria, respekti, barazia, toleranca, të drejtat e barabarta, solidariteti, shprehja e lirë e mendimit etj. Siç e dini, Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, ku populli del dhe voton. Ato vota numërohen dhe zgjedhen deputetët apo përfaqësuesit e vendit. Pra, populli në demokraci vet vendos për të ardhmen

e shtetit të vet, duke i zgjedhur përfaqësuesit e duhur të cilët do të propozojnë dhe miratojnë projektligje në Kuvend. Këto ligje që merren në Kuvend e ndikojnë mënyrën e jetesës tonë. Për shembull, ligjet për arsim, shëndetësi, infrastrukturë, bujqësi ndikojnë shumë në jetën tonë. Pra, lexues të dashur siç e keni lexuar më lart, demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes dhe nevojitet kontributi i çdo qytetari të Republikës së Kosovës në mënyrë që ti fuqizojmë elementet e demokracisë dhe t'i zbatojmë ato.

Prandaj, ne ju ftojme të gjithëve që të jeni qytetarë aktiv në vendin tuaj, sepse vetëm kështu mund të jetojmë të gjithë të lirë dhe të pavarur. Mos harroni asnjëherë, se ndryshimi fillon nga ne dhe ne jemi ata që duhet të punojmë më së shumti për të bërë ndryshime në shtetin tonë demokratik. Mesazhi ynë për ju është: shprehe mendimin tënd lirshëm, sepse në demokraci fjala jote ka vlerë.



Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik



E ardhmja e vendit




Pushteti i cili merret me drejtësinë në Kosovë




Funksionet që i kryen Pushteti Legjislativ - Kuvendi



Vetëm me punë arrijmë synimet tona



Të gjithë jemi të barabartë në të drejtat e përgjegjësitë tona




Ligjet duhet të përputhen me Kushtetutën



Secili qytetarë është i rëndësishëm në shtetin e vet

NDARJA E DETYRAVE NË KOSOVË

ZEQIRI (13), SHPRESA (13), FERATI (13), ALBINA (14), EDI (14), DEA (13), VALMIRI (13)



Ne mendojmë se demokracia është djepi i civilizimit, për këtë arsye vlen ta duam dhe të punojmë për të

Barazi do të thotë gjithçka. Çdo njeri ka të drejtë t'i kërkojë të drejtat e veta dhe të jetë i pavarur. Edhe mendimet duhet të rrjedhin të lira.

Të gjitha këto gjëra të lartpërmendura përmbushen nga sistemi demokratik.

Fjala demokraci do të thotë udhëheqje e popullit qoftë vet apo me anë të përfaqësuesve, gjegjësisht deputetëve apo Presidentit. Çdo gjë fillon nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Ky komision organizon zgjedhje, ku qytetari në moshë madhore (mbi 18 vjeç), ka të drejtën e votës, duke mos qenë nën ndikimin e askujt. Qytetari duhet ta votojë atë i cili i duket më i përshtatshëm për udhëheqjen e vendit, për 4 vite me radhë.

Sikurse çdo njeri nga ne që e ka një detyrë të caktuar p.sh. shkuarja në shkollë, kujdesi ndaj të tjerëve etj, edhe pushteti i një shteti i ka punët e ndara.

Në Kosovë pushteti ndahet në këtë mënyrë: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe ai Gjyqësor.

Pushteti Legjislativ ka për bazë Kuvendin i cili ndryshe njihet si Parlamenti. Ai i cili ka për detyrë miratimin apo mos miratimin e ligjeve dhe njëkohësisht ka punën kontrolluese sepse ministrat paraqesin para Kuvendit raportin mbi punën e bërë.

Kuvendi ynë ka 120 ulëse, ku 20 prej tyre janë të garantuara për komunitetet jo shumicë.

Pushteti Ekzekutiv udhëhiqet nga Kryeministri i cili zg-

jedhet nga Kuvendi. Pushteti Ekzekutiv përbëhet nga kabineti qeveritar i zgjedhur nga vetë Kryeministri.

Në qeverisjen e tij, kryeministri i ndan punët me qëllim që të gjejë njerëz sa më të aftë dhe të përgatitur për qeverisje.

Mandati zgjatë 4 vite dhe pastaj, organizohen zgjedhje të reja ku ne si qytetarë me anë të votave, vendosim për të ardhmen e shtetit tonë.

Pushteti Gjyqësor bazohet në ligje, që do të thotë se aty vendoset drejtësia. Ekzistojnë gjykata të caktuara për shkeljen e ligjeve. Në Kosovë kemi tri lloje të gjykatave. Gjykata më e lartë është ajo Supreme, pastaj vijon me Gjykatën e Apelit si dhe ajo Themelore. Kur sistemi Gjyqësor vepron në mënyrë demokratike, vendi ka drejtësinë në nivel të lartë. Me pak fjalë, në demokraci çdo kush e ndien veten të rëndësishëm, ndihet kompetent dhe ndien se i përket një shteti.



Të punojmë sot për një të nesërme më të mirë


SISTEMI ZGJEDHOR I KOSOVËS

EDON (14), ALTIN (13), XHOVAN (14), ENKELENA (13), ALMEDINA (13), KALTRINA (14)


Në këtë artikull tregohet rreth mënyrës së zgjedhjeve, sistemit të qeverisjes dhe të Kuvendit të Kosovës. Poashtu ne flasim rreth deputetëve, qeverisjes momentale, dhe llojeve të zgjedhjeve

Zgjedhjet janë proces i zgjedhjes së personaliteteve të cilët përfaqësojnë interesat dhe qëllimet e qytetarëve. Zgjedhjet në Kosovë ndodhin çdo 4 vite, pasi që qeverisja jonë është e formës demokratike ku populli zgjedh përfaqësues të ndryshëm. Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet qendrore. Zgjedhjet komunale apo lokale janë ato zgjedhje ku në komuna ne zgjedhim një kryetar të komunës dhe asambleistët, të cilët votohen nga qytetarët e asaj komune. Ata votojnë atë për të cilin mendojnë se do ta qeverisë komunën më së miri. Kurse, zgjedhjet qendrore apo parlamentare janë ato zgjedhje ku votojmë për disa parti dhe kandidatë të cilët formojnë Kuvendin e Kosovës. Ne votojmë për 120 deputetë në Kuvendin tonë. Nga këta 120 deputetë, 100 janë shqiptarë,

ndërsa 20 janë të komuniteteve jo shumicë si komuniteti romë, ashkali, serbë, boshnjak, turk, dhe egjiptian. Në Kosovë kompetencat për zgjedhjen e institucioneve e ka Kuvendi ynë, sepse deputetët zgjedhin Kryeministrin, Presidentin, dhe Kryetarin e Kuvendit. Kryeministri udhëheq Qeverinë dhe ka mandat 4 vjeçar, ndërsa Presidenti ka mandat 5 vjeçar dhe udhëheq Presidencën e shtetit tonë. Ne fëmijët nuk marrim pjesë në zgjedhje demokratike deri në moshën 18 vjeçare, por ne marrim pjesë në zgjedhjet e jetës së përditshme. Në shkollë ne zgjedhim kryesinë e klasës, zgjedhim ushqimin që do të hajmë dhe zgjedhim ekipet kur marrim pjesë në ndonjë sport. Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme, pasi që ato ndikojnë jetën tonë dhe po ashtu zhvillimin e shtetit tonë.



E drejta e votës mbi moshën 18 vjeçare



Barazia gjinore



Ne punojmë për të ardhmen



Të drejtën e votës e kemi të gjithë



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Emin Duraku“
Klasa: 8/3
Vendi: Prishtinë